



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 22.08.2025

Numër Protokolli :5691/2025

A.nr.1242/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1242/2025, të datës 27.06.2025, të parashtruar nga ankuesi B.H, nga Podujeva, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1242/2025, e datës 27.06.2025, e parashtruar nga ankuesi B.H.

II. Anulohet Njoftimi me numër protokolli 1953, i datës 28.05.2025, për kandidatin fitues si dhe **anulohet** Njoftimi i datës 30.04.2025 i Njesisë së Burimeve Njerëzore për refuzimin e aplikacionit të ankuesit, ndërsa lënda kthehet ne **rishqyrtim** dhe **rivendosje** në fazën e verifikimit paraprak.

III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, duke ndërmarr të gjitha veprimet që procedurën e pranimi ta zhvilloj si në pikën **II** të dispozitivit.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi sikurse është përcaktuar në pikën **III** të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil B.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 27.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 29.04.2025 të protokolluar më datë 30.04.2025, me që rastë ankuesit i ishte refuzuar aplikacioni përkatësisht kundër njoftimit me numër protokolli 1953, të datës 28.05.2025, për kandidatin fitues të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me procedurën e pranimi sipas konkursit me Nr. Reference RN00017398, për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa", i shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje MBPZHR), ndërsa kjo e fundit, më datë 10.07.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 06.08.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 5268/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1242/2025 të datës 27.06.2025 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4412/2025 të datës 27.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin e datës 15.12.2023; Vërtetimin e datës 06.02.2025; Akt Emërimit e datës 27.12.2024; Pasqyrën e llogarisë së trustit; Vendimin e datës 19.12.2024; Kopjen e pasaportës së ankuesit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 10.07.2025; Shkresë e datës 24.03.2025 me shifër: 1138; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e kontestuar; Konkursin e datës 24.03.2025; Njoftimin e datës 30.04.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin Ref.ZSP-308/25 të datës 12.05.2025 për themelimin e komisionit të pranimi, e akt emërimet dhe vendimet përkatëse të anëtarëve; Njoftimin e datës 29.04.2025; Testet me shkrim; Formularin e vlerësimit të esesë datë 21.05.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për kandidatët; Formularin e renditjes përfundimtare; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 28.05.2025; Aplikacionin e kandidati fitues i datës 22.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur faqe 1-18; Aplikacionin e kandidati N.Q i datës 22.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e ankuesit i datës 23.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomë e datës 13.02.2020; Vërtetimet e lëshuara nga KQZ; Referencë e datës 08.07.2020 lëshuar nga KQZ; Vërtetimin e lëshuar nga KQZ;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstatoi se MBPZHR, më datë 24.03.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference RN00017398, për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa", me afat aplikimi nga data 25.03.2025 deri me datë 23.04.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë tetë (8) kandidatë, ku prej tyre pesë (5) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, ndërsa ankuesit sipas Njoftimit të datës 30.04.2025 i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, që ndërlidhen me përvojën e kërkuar profesionale prej tre (3) vitesh.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MBPZHR, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht me datë 28.05.2024 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 1953 për kandidatin fitues për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*, nga i cili njoftim rezulton se kandidati R.H ka marr më së shumti pikë respektivisht 87.2 pikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare, pretendon se organi i punësimit ia ka refuzuar pa të drejtë aplikacionin, me arsyetimin se i njëjti i ka tri (3) vite të përvojës së punës profesionale në fushën e pagesave direkte, madje i njëjti pretendon se Këshilli sipas Vendimit A.nr.127/2025 të datës 18.03.2025 kur kishte vendosur konkursin paraprak (23.10.2024-21.11.2024) për pozitën e njëjtë, kishte konstatuar se ankuesi asaj kohe i kishte vetëm dy (2) vite e shtatë (7) muaj përvojë pune profesionale, ashtu që nga data respektive deri ne datën e fundit 23.04.2025 të mbylljes së konkursit të tanishëm janë plotësuar edhe pesë (5) muaj të tjerë, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e tij, ndërsa të kthej në pikën zero konkursin e kontestuar.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me numër reference RN00017398, për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*, si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Fakultetin Ekonomik; Kërkesat specifike:* *Certifikata, licenca kur kërkohet me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë*

arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Mbështetur në konstatimin e dhënë si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, dhe me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike nëse i njëjti ka përmbushur kriterin e konkursit në fjalë që ndërlidhet me përvojën e punës prej tre (3) vitesh, Kolegji i Këshillit analizoi përmbajtjen e dokumentacioneve të ankuesit të bashkangjitura me rastin e aplikimit me datë 23.04.2025 në konkursin me shifër RN00017398, për pozitën e punës ”Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa”, dhe konstatoi se ankuesi posedon Diplomën e datës 13.02.2020 me shifër: 10865 përmes së cilës konstatohet fakti se i njëjti me datë 11.02.2020 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “*Hasan Prishtina*”, kurse lidhur me përvojën e punës profesionale në fushën që ndërlidhet me pozitën e shpallur, i njëjti posedon Vërtetimin me numër protokolli 533 të datës 06.02.2023, të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me të cilën dëshmohet se i njëjti nga data 15.02.2022 deri më 14.02.2023, ka qenë i angazhuar në pozitën *Konsulent për Pagesa Direkte* në kohëzgjatje prej (1) një viti dhe po ashtu posedon Vërtetimin me numër protokolli 8144, të datës 15.12.2023, të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me të cilën dëshmohet se të njëjtit, i është vazhduar kontrata-*Shërbime për Konsulent lidhur me programin e pagesave direkte*, dhe atë nga data 20.04.2023 deri më 19.04.2026, ndërsa po ashtu i njëjti posedon Akt Emërimit e nënshkruar të datës 20.12.2024 përmes së cilës konstatohet fakti se i njëjti ka themeluar marrëdhënien e punës në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në pozitën “*Zyrtar i lartë i pagesave direkte*”, prandaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, në bazë të provave të lëndës të paraqitura me rastin e aplikimit të datës 23.04.2025, ankuesi e ka përmbushur kriterin e përgjithshëm që ndërlidhet me përvojën e punës prej tre (3) vitesh ngase, i njëjti prej periudhës kohore nga data 15.02.2022 deri më 14.02.2023 ka pasur një (1) vite përvojë unë profesionale në fushën përkatëse, si dhe po ashtu prej datës 20.04.2023 e deri në momenti e aplikimit me datë 23.04.2025 ka pasur edhe dy (2) vite të tjera të përvojës së punës profesionale pa shpallje, konstatim ky i cili dëshmohet përmes Vërtetimit me numër protokolli 8144, të datës 15.12.2023 dhe Akt Emërimit të datës 20.12.2024.

Nisur nga ky fakt, si në kontestimin e dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e aplikuara Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, nenin 7 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 ku përcaktohet se: “*7.1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 9.1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak.*”, dhe konstatoi se Njësia e

Burimeve Njerëzore e MBPZHR me rastin e refuzimit të aplikacionit përmes Njoftimit të datës 30.04.2025 ka zbatuar gabimisht dispozitat e kësaj rregullore të cekura si më lartë si dhe ka zbatuar gabimisht ligjin material, respektivisht dispozitat e nenit 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë që lidhet me përmbushjen e kriterit të përvojës së punës.

Ndërlidhur me konstatimin e dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë Kolegji i Këshillit mori vendimin të anuloi Njoftimin nr.1627 të datës 30.04.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore për refuzimin e aplikacionit të ankuesit, dhe po ashtu të anuloi Njoftimin me numër protokolli 1953 të datës 28.05.2025 për kandidatin fitues për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*, ndërsa lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e verifikimit paraprak, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e përsëritjes së fazës së verifikimit paraprak duhet të marrë për bazë pikëpamjet e dhëna juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1242/2025, datë 22/08/2025

Flakron GASHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.H;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MBPZHR; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.